



Republika e Kosovës - Vlada e Kosovës - Government of Kosovo			
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë / Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade			
AGENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE, AGENCIJA ZA REGISTRACIJU BIZNISA, BUSINESS REGISTRATION AGENCY, QENDRA KOMUNALE E BIZNESIT-OPŠTINSKI CENTAR BIZNISA			
Njësia Org. Org. Unit	11	Nr. Prot. Br. Prot.	299
Nr. i faq. Brest.	2	Data: Datum:	05/06/2025

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë / Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine  
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa / Kosova  
Business Registration Agency

Ref: \_\_\_\_\_

Datë: 05.06.2025

Drejtorja Ekzekutive e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), bazuar në nenin 10 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare dhe me qëllim të zbatimit të Strategjisë së Kosovës për Qeverisje Elektronike/administratën publike dhe ofrimin e shërbimeve më efikase për qytetarët dhe bizneset, merr këtë:

**VENDIM**

**Për fillimin e regjistrimit të shoqërive tregtare përmes platformës elektronike e-Kosova**

1. Duke filluar nga data **9 Qershor 2025** regjistrimi fillestar i shoqërive tregtare në Republikën e Kosovës do të mundësohet edhe përmes platformës elektronike **e-Kosova**.
2. Nga kjo datë, regjistrimi i shoqërive tregtare përmes platformës **e-Kosova** do të jetë plotësisht online. Aplikimi, miratimi i lëndës dhe lëshimi i certifikatës elektronike do të bëhet përmes kësaj platforme, pa pasur nevojë që aplikuesi të paraqitet në sportele të ARBK-së dhe të dorëzoj dokumentet në formë fizike.
3. Regjistrimi përmes sistemit ekzistues **e-Regjistri i Biznesit** do të vazhdojë të funksionojë në mënyrë pjesërisht elektronike, ku aplikimi dhe miratimi bëhen online, ndërsa certifikata mund të merret në sportelet e ARBK-së apo në Qendrën Komunale të Biznesit (QKB) në Komunën ku biznesi ushtron veprimtarinë ekonomike.
4. Dokumentet e bashkangjitura nga aplikuesi në formë elektronike, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij vendimi, do të arkivohen në formë fizike nga zyrtarët e ARBK-së apo QKB-të. Aplikuesi nuk obligohet të dorëzoj dokumentet në formë fizike në ARBK apo QKB-të.

5. Përmes platformës *e-Kosova*, bizneset do të kenë mundësi të sigurojnë informatat dhe historinë e biznesit në mënyrë të plotë elektronike, pa pasur nevojë të paraqiten në sportelet e ARBK-së.

6. **Aplikimi për** regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare qoftë përmes e-Kosova, sistemit e-Regjistri i Biznesit, apo në mënyrë fizike në sportelin e ARBK-së apo QKB-së, vazhdon të jetë pa pagesë.

7. Sportelet e ARBK-së dhe QKB-ve do të vazhdojnë të jenë të hapura dhe të operojnë për bizneset dhe qytetarët për shërbimet që kërkohen në formë fizike.

### Arsyetim

ARBK duke u mbështetur në nenin 10 dhe 15 të Ligjit Nr.06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, me qëllim të digjitalizimit dhe rritjes së transparencës në ofrimin e shërbimeve më efikase për qytetarët dhe bizneset në Republikën e Kosovës, nga data 9 Qershor 2025, ofron mundësinë që shoqëritë tregtare të regjistrohen edhe përmes platformës *e-Kosova*, si dhe të marrin edhe shërbime të tjera të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Regjistrimi fillestar i bizneseve në platformën *e-Kosova* mundëson një proces më të shpejtë dhe më efikas, duke reduktuar burokracinë dhe mundësuar që qytetarët dhe bizneset të realizojnë procedurat administrative online.

Platforma do të sigurojë ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke i mundësuar bizneseve akses të sigurtë në informacionet e tyre.

Ky vendim ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit të procesit të regjistrimit të bizneseve dhe ofrimin e mundësisë për qytetarët dhe bizneset që të regjistrojnë biznesin dhe të sigurojnë dokumentet në mënyrë elektronike, duke eliminuar nevojën për të kryer procedura fizike. Me këtë rast, procesi bëhet më i thjeshtë, më i shpejtë dhe më transparent, duke lejuar që informacionet të jenë në dispozicion të gjithëve përmes platformës e-Kosova, pa pasur nevojë të paraqiten në zyrat e regjistrimit. Ky zhvillim i teknologjisë do të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe do të mundësojë një administratë më të shpejtë dhe më efikase.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Lebibe HALITI

zv.Drejtoreshë Ekzekutive në ARBK